

VENDIM
Nr.1211, datë 11.12.2009

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE SHITESË TË PRANIMIT NË PROGRAMET E
STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS
DHE NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2009-
2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e 170 kuotave shtesë për pranimin në programet e studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë” (MND), në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010.

2. Kuotat shtesë për pranimin, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahen në universitetet, fakultetet dhe programet përkatëse të studimit, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kuotat e paplotësuara në programet e studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1: Shpërndarja e kuotave shtesë të pranimin në MND, sipas universiteteve dhe programeve përkatëse të studimit

A. UNIVERSITETI I TIRANËS

NR.	PROGRAMI I STUDIMIT TË MND-SË	FAKULTETI	KUOTA
1	SHKENCA JURIDIKE CIVILE	FAKULTETI I DREJTËSISË	50
2	SHKENCAT PENALE	“	50
3	E DREJTA KUSHTETUESE, E KRAHASUAR DHE EUROPIANE	“	50

B. UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

NR.	PROGRAMI I STUDIMIT TË MND-SË	FAKULTETI	KUOTA
1	TEKNOLOGJI MJEDISI	FAKULTETI I BUJQËSISË DHE	10

		<i>MJEDISIT</i>	
2	<i>MENAXHIMI I RESURSEVE DHE PËRMIRËSIMI GJENETIK I BIMËVE</i>	“	10